



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2025:115419

Datë: 22.10.2025

Numri i dokumentit: 07933088

K.DH.SH.II.nr.1476/25

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha, kryetar, Fisnik Nuli dhe Alajdin Tershnjaku, anëtarë, në konfliktin administrativ të paditësit-propozuesit Grami SHPK me NUI:810851073 me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve HPHS Law në Prishtinë, kundër të paditurve 1. Organi Shqyrtues i Prokurimit në Prishtinë dhe 2. Korporata Energjetike e Kosovës SHA me seli në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi dhe propozim për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, duke vendosur lidhur me ankesat e palëve të paditura, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale - Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për çështje administrative, K.A.nr.277/25 datës 14.07.2025, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 16.10.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHEN Pjesërisht ankesat e të paditurve 1. Organi Shqyrtues i Prokurimit në Prishtinë dhe 2. Korporata Energjetike e Kosovës SHA me seli në Prishtinë, NRYSHOHET pika III e dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për çështje administrative K.A.nr.277/25 i datës 14.07.2025, ashtu që vendoset si në vijim:

II. REFUZOHET propozimi i paditësit – propozuesit Grami SHPK me NUI:810851073 SHPK, me të cilën ka kërkuar Shtyrjen e ekzekutimit të vendimit numër OSHP:2024:1222 datës 02.05.2025 të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit në Prishtinë

III. REFUZOHEN ankesat e të paditurve 1. Organi Shqyrtues i Prokurimit në Prishtinë dhe 2. Korporata Energjetike e Kosovës SHA me seli në Prishtinë, sa i përket pikës I dhe II të dispozitivit të Aktgjykimit K.A..nr.277/25 datës 14.07.2025 të Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për çështje administrative

A r s y e t i m

Paditësi Grami SHPK me NUI:810851073 me seli në Prishtinë, me datë 05.06.2025 ka ushtruar padi kundër të paditurve 1. Organi Shqyrtues i Prokurimit në Prishtinë dhe 2. Korporata Energjetike e Kosovës SHA me seli në Prishtinë, respektivisht ka kundërshtuar vendimin e Organit Shqyrtues të Prokurimit numër OSHP:2024:1222 datës 02.05.2025 dhe Njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues Korporata Energjetike e Kosovës SHA për aktivitetin e prokurimit “furnizim me gëlqere të hidratizuar” me numër prokurimit KEK-24-2567-1-1-1 dhe lënda të kthehet në rigjykim ose të obligohen të paditurat që në mënyrë solidare paditësit t,ia kompensojnë dëmin e shkaktuar dhe fitimin e humbur. Me të njëjtën parashtrësë propozuesi/paditësi ka paraqit kërkesë për caktimin e masës së sigurisë, duke i propozuar gjykatës që të aprovet në tërsi propozimi për caktimin e masës së sigurisë, të shtyhet ekzekutimi i vendimit të atakuar dhe të detyrohet kundërpropozuesi i dytë që të pezulloj zbatimin e kontratës publike.

Në padi paditësi deklaron se me të paditurin e dytë KEK SHA ka histori të gjatë në aktivitete të prokurimit, e rrjedhimisht ka aplikuar në tenderin sipas aktivitetit të prokurimit “furnizim me gëlqere të hidratizuar” m numër prokurimit KEK-24-2567-1-1-1 nën kushtet dhe llojin e njëjtë të dokumentacionit të kërkuar, por që tani në këtë aktivitet është shpallur ofertues i përgjegjshëm pa të drejt dhe pa shqyrtim meritore të aplikacionit dhe dosjes së tenderit. Paditësi konsideron se natyra e propozimit të tij është urgjente në vendosje pasi që i padituri i dytë e ka nënshkruar marrëveshjen me OE Geo Conex&Dini, ndërkaq nuk ka ndërmarr asnjë veprim në zbatimin e vendimit gjyqësor, duke shpërfillur tërsisht masën e sigurimit të vendosur me aktgjykimin e kësaj gjykate KA.nr.132/25. Rrjedhimisht zbatimi i kontratës së kundërshtarit të dytë përveç se do të shkaktonte dëme të mëdha propozuesit në emër të fitimit të humbur, do të krijonte një praktikë të gabuar e cila shkakton dëme të pakthyeshme propozuesit si dhe dëme të mëdha buxhetit shtetëror për shkak të çmimit më të lartë të ofertuar nga fituesi i shpallur në raport me propozuesin e sigurimit. Më tej ka shtuar se me caktimin e masës së

sigurimit të propozuar nuk çënohet rëndë interesi publik pasi që i padituri i dytë ndonëse e ka shpërblyer me kontratë OE Geo Conex&Dini për furnizim me gëlqere për sasinë 1000 ton date 12.07.2024. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet kërkesa për caktimin e masës së sigurimit ndërsa sa i përket kërkesëpadisë ka kërkuar që e njëjta të aprovohet në tërsi si e bazuar dhe të anulohet si i paligjshëm vendimi i OSHP-së.

I padituri i parë OSHP-se në parashtrësën e datës 20.06.2025 ka kundërshtuar në tërsi propozimin e caktimit të masës së sigurimit duke theksuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për caktimin e masës, propozuesi nuk e ka provuar dëmin e rëndë që kanoset ti shkaktohet pasi që ai nuk i ka plotësuar kushtet sa i përket dokumentacionit për tu shpallur fitues i aktivitetit të prokurimit pasi që në dosjen e tij ka munguar dokumenti sipas dosjes se tenderit. Propozuesi nuk e ka dëshmuar se me caktimin e masës së sigurimit nuk e çënon rëndë interesin publik. I ka propozuar gjykatës që re refuzohet propozimi i paditësit për caktimin e masës së sigurimit.

I padituri i dytë KEK SHA ka kundërshtuar në tërsi propozimin për caktimin e masës së sigurimit, sepse në cilësin e autoritetit kontraktues është i obliguar që të veproj sipas vendimit përfundimtar të OSHP-së, ndërkaq duke parë natyrën e kontestit caktimi i masës së sigurimit nuk ka asnjë kuptim faktik e as juridik për caktimin e saj. Më tej thekson se nuk janë plotësuar asnjëra nga kushtet për caktimin e masës së sigurimit duke i kundërshtuar të gjitha arsyetimet e propozuesit si të pabazuara, sepse vlerëson se AK ka vepruar në përputhje me vendimin e OSHP-së dhe nuk ka ndërmarr asnjë veprim joligjor. Më tej i mbështet të gjitha arsyetimet dhe sqarimet e OSHP-së duke i cilësuar ato si të qarta sa i përket shkaqeve se pse propozuesi është eliminuar në aktivitetin publik të prokurimit.

Dhoma e shkallës së parë, me Aktgjykimin KA.nr.277/25 datës 14.07.2025 ka aprovuar si të bazuar padinë dhe propozimin e paditësit për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të paditurës, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Në arsyetim të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë vlerëson se vendimi me të cilin aprovohet pjesërisht e bazuar ankesa e paditësit Grami SHPK, është në kundërshtim me arsyetimin, sepse as në dispozitiv të këtij vendimi dhe as në arsyetim nuk mund të konstatohet se cilat pretendime të ankesës janë aprovuar pjesërisht, në këtë kuptim vendimi kontestues i të paditurës është i paqartë dhe kundërtëhënës dhe në kundërshtim me nenin 48 të LPPA-së. Gjykata obligon të paditurën OSHP që në procedurë të rishqyrtimit të veproj sipas vërejtjeve të

dhëna në aktgjykim. Gjykata konstatoi se vendimi i kundërshtuar është i kundërligjshëm bazuar në nenin 100 par.1 të LKA-së për caktimin e masës së sigurisë, gjykata vlerëson se duhet të pezullohet ky vendim deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale të Kosovës, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenit 90 të LKA-së, ka gjetur se:

Ankesat janë pjesërisht të bazuara

Dhomat e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes duke ekzaminuar aktgjykimin e ankimuar, aktvendimin kontestues të paditurit të goditur me padi, shkresat e lëndës, vlerësimit të pretendimeve ankimore të paditurve, gjen se aktgjykimit i ankimuar është përfshirë pjesërisht me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika n) i LPK-së, se është juridikisht i pa qartë kundërthënës me vet vetën dhe arsyetimin e tij sa i përket pikës III të dispozitivit të Aktgjykimit ankimor, prandaj kjo gjykatë ka vendos që ta ndryshoj pjesërisht aktgjykimin e atakuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sipas vlerësimit të Kolegjit, në rastin konkret nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për pezullimin e aktit administrativ numër OSHP:2024:1222 datës 02.05.2025 të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit, të paraparë në nenin 100 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Me këtë dispozitë juridike është paraparë që:

1. Masa e sigurisë e përcaktuar në paragrafin 1 dhe 2, të nenit 99 të këtij Ligji, mund të vendoset nëse nga një shqyrtim paraprak, Gjykata, vlerëson se plotësohen këto kushte: 1.1.marrja e masës së sigurisë është e domosdoshme për të shmangur një dëm të rëndë, të pakthyeshëm ndaj interesave të propozuesit të masës; 1.2.marrja e masës së sigurisë nuk cenon rëndë interesin publik.

Në rastin konkret paditësi-propozuesi, me propozimin për caktimin e masës së sigurimit, ka kërkuar që të detyrohet e paditura e dytë që të pezulloj zbatimin e kontratës publike nga aktiviteti i prokurimit deri në shqyrtimin meritore të çështjes.

Kolegji i kësaj gjykate, pikëpamjet juridike të Dhomave të shkallës së parë, lidhur me vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, nuk mund ti përkrah si të rregullta dhe të ligjshme për arsye se pika III e dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, është përfshirë edhe me të meta juridike për shkak të qëndrimit të gabuar juridik të Dhomave të shkallës së parë, të parapara me nenin 183, respektivisht 183.1 ku përcaktohet se: *“Ekziston vërtetimi i gabuar apo jo i plotë i gjendjes faktike kur gjykata gabimisht e ka vërtetuar ndonjë fakt vendimtar, përkatësisht kur faktin e tillë nuk e ka vërtetuar fare”*. Në rastin konkret Dhoma e shkallës nuk ka arritur të jep arsye bindëse se caktimi i masës së sigurimit- Shtyrja e ekzekutimit të vendimit numër OSHP:2024:1222 datës 02.05.2025, është e domosdoshme për të shmangur një dëm të rëndë të pakthyeshëm ndaj interesave të paditësit në raport me zhvillimin e aktivitetit të prokurimit nga palët e paditura, ndërkaq lidhur me kushtin e mos cenimit të interesit publik, Dhoma e shkallës së parë, është mjaftuar vetëm me parregullsitë e vendimit kontestues të paditurit OSHP-së.

Dhoma e shkallës së parë nuk ka arritur të konkretizojë dëmin potencial për palën paditëse/propozuesit, në raport me vendimet e kontestuara të paditurve, prandaj Dhoma e Shkallës së Dytë qëndrimin e tillë nuk mund ta pranojë si të drejtë, pasi që vlerësimi i dëmit duhet të kufizohet në dëmin që mund t'i shkaktohet palës paditëse, nga aktet apo veprimet administrative, e që në rastin konkret kemi të bëjmë me një aktivitet të rregullt të prokurimit nga autoriteti kontraktues. Sipas Kolegjit, interesi publik përfaqëson të mirën publike dhe të shoqërisë në përgjithësi, që synohet të rregullohet me aktin administrativ. Në këtë rast Dhoma e shkallës së parë, ka pasur për obligim që të shqyrtoj vetëm kërkesat ligjore, nga neni 100 të LKA-së, që parasheh: *Masa e sigurisë e përcaktuar në paragrafin 1 dhe 2, të nenit 99 të këtij Ligji, mund të vendoset nëse nga një shqyrtim paraprak, Gjykata, vlerëson se plotësohen këto kushte: 1.1.marrja e masës të sigurisë është e domosdoshme për të shmangur një dëm të rëndë, të pakthyeshëm ndaj interesave të propozuesit të masës; 1.2.marrja e masës së sigurisë nuk cenon rëndë interesin publik, ndërsa Dhoma e shkallës së parë gabimisht e referon arsyetimin e vendimit kontestues për masën e sigurisë, në çështjen kryesore të kontestit.*

Vendimi i Dhomës së Shkallës së Dytë, për refuzimin e propozimit për caktimin e masës së sigurimit, nuk e prejudikon çështjen kryesore, por ka të bëjë vetëm sa i përket pezullimit të ekzekutimit të vendimit të paditurës OSHP-së.

Kolegji vlerëson, se e paditura e dytë Organi Shqyrtues i Prokurimit në Prishtinë, në rivendosje ti zbatoj vërejtjet e gjykatës së shkallës së parë, ashtu që të nxjerr vendim të ri administrativ duke ndërtuar dispozitivin e qartë të vendimmarrjes, sa i përket ankesës së ankuesit-paditësit Grami SHPK, lidhur me aktivitetin e prokurimit “ furnizim me gëlqere të hidratizuar” nr.prok. KEK-24-2567-1-1-1 të iniciuar nga AK KEK.

Kolegji i kësaj gjykate, duke i marrë parasysh pretendimet ankimore, propozimin e masës së sigurimit, aktgjykimin e ankimuar, dhe provat të cilat gjenden në padi dhe në shkresat e lëndës, në përputhje me nenin 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenin 90 të LKA-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.1476/25 datë 16.10.2025

Kryetari i Kolegjit

Krenar Berisha